



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 23, Datë 22.02.2012

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetare |
| - Z. Gerdjan Xhanari | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtare |
| - Z. Zamir Mocka (Stefani) | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2012, vazhdoi shqyrtimin e ankesës se ardhur nga Korab Halilaj (ne emër të se bijës Blerina Halilaj), ne lidhje me praktiken e ndjekur nga Ndërmarrja e Trajtimit të Studenteve sh.a, Shkodër, ne rastet kur studentet kanë kryer parapagimin e tarifës së qirasë vjetore, sipas kontratës, dhe kur studenti vendos për të mos përmbushur kontratën e qirasë, që ne rastin konkret është për arsye objektive të fitimit të një burse ne një universitet të një rrethi tjetër.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës se sipërpërmendur,

VËREN SE:

Shqyrtimi i kësaj ankese ka filluar ne mbledhjen e datës 27.01.2012 dhe, për një vlerësim të plote të kësaj çështjeje, Komisioni, me shkresë nr .prot 45, date 31.01.2012, i ka kërkuar Ndërmarrjes së Trajtimit të Studenteve sh.a, Shkodër informacion ne lidhje me ankesën e Korab Halilaj (bashkëlidhur shkresës ne fjale) si dhe një kopje të kontratës tip të qirasë midis Trajtimit të Studenteve Shkodër dhe studenteve.

Komisioni konstaton se, Ndërmarrja e Trajtimit të Studenteve Shkodër nuk ka dhënë akoma asnjë informacion, duke kaluar edhe afatin e datës 7 janar 2011 që ishte kërkuar nga Komisioni ne shkresën e lartpërmendur.

Komisioni ka marre ne shqyrtim kontratën, e dorëzuar nga Korab Halilaj, e cila ishte firmosur nga e bija Blerina Halilaj dhe Drejtori i Ndërmarrjes, Bashkim Rroji.

Sipas pikës 4.3 të kësaj kontrate:

“Kur qiramarrësi prish kontratën në mënyrë të njëanshme dhe mandat arkëtimi është i prere, qiradhënësi nuk ka të drejtë t’i kthejë diferencën e qirasë qiramarrësit”

Me tej, pika 5.3 e kësaj kontrate përcaktonte se:

“Nëse studenti bën pagimin e tarifës së regjistrimit në konvikte, kjo tarife do të konsiderohet e pakthyeshme”

Pika 4.3 dhe 5.3, e kontratës së lartpërmendur, përbëjnë kushte të padrejta në kontrate, referuar pikës 4(ç) të nenit 27 të ligjit 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” i ndryshuar:

“Janë kushte padrejta në kontrata, të drejtat e tregtarit, kur:

ç) lejojnë tregtarin për të mbajtur shumën e paguar nga konsumatori, kur ky i fundit vendos për të mos e përmbushur kontratën, pa parashikuar për konsumatorin marrjen e një shume ekuivalente nga tregtari, kur ky i fundit është pala që ndërpret kontratën”

Sipas nenit 28, “Kërkesat e transparencës” të ligjit 9902 për mbrojtjen e konsumatorëve:

Neni 28, pika 2: *“Në rastin kur kushti konsiderohet i padrejtë, ai quhet i pavlefshëm që nga koha që është lidhur kontrata. Kushtet e tjera mbeten detyruese për palët dhe zbatimimi i mëtejshëm i kontratës është i mundshëm”.*

Gjithashtu, moskthimi i tarifës vjetore prej 35.000 leke, ka shkaktuar dem tek ankimuesi Korab Halilaj dhe, sipas pikës 5 të nenit 57 të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve, përcaktohet se

“Kur komisioni në shqyrtimin e kundërvajtjes administrative konstaton shkaktim dem, si pasojë e kundërvajtjes administrative, pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, vlerëson masën e demit dhe me një vendim të veçantë vendos për shpërblimin e demit.

Masa e shpërblimit si dhe pagesa për vlerësimin e demit i ngarkohen subjektit që ka kryer kundërvajtjen administrative”

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, mbështetur në pikën 4 të nenit 52; shkronjën “ç”, pika 4 të nenit 27; pikën 2 të nenit 28; pikën 5 të nenit 57 të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në shkronjat “a” dhe “b”, pika 6 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit të pagesës së anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”.

VENDOSI:

1. Ndërmarrja e Trajtimit të Studenteve sh.a, Shkodër, të dëmshpërbleje Blerina Halilaj me shumën prej 35 000 leke.

2. Kushtet e përcaktuara ne Kontratën e Qirasë ne pikat 4.3 dhe 5.3 shfuqizohen.
3. Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a Shkodër, te marre masat për ndreqjen e shkeljes dhe mos përsëritjen e praktikave te tilla.
4. Ndërmarrja e Trajtimit te Studenteve sh.a, Shkodër te njoftoje menjëherë, Komisionin e Mbrojtjes se Konsumatorëve për dëmshpërblimin e Blerina Halilaj, brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit te këtij Vendimi.

Kundër Vendimit te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorit keni te drejte te ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

ANILA JANI

